



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO		
KOMUNA E PODUJEVËS / OPŠTINA PODUJEVO / MUNICIPALITY OF PODUJEVA		
DIREKTORIA E ADMINISTRATËS - UPRAVA ADMINISTRACIJE		
Dërguar më Dostavljeno	19.05.2025	
Nr. org. Org. jed.	Nr. Br.	Shtojcë - Prilog
01-060/03-0027381/25		

Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosovo
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KRYESUESI I KUVENDIT

Njoftim / Ftesë për vazhdimin e seancës së Kuvendit të Komunës të datës 18 prill 2025.

Të nderuar/a

Siç e dini, në mbledhjen e Kuvendit të Komunës të datës 18 prill 2025, ndër çështjet tjera ka qenë në shqyrtim edhe pika e rendit të ditës (pika 10) Propozim vendimi për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës Ndërmarrjes Publike Lokale "Eko Llapi" Sh.A në Podujevë.

Sa për rikujtim, për këtë pikë të rendit të ditës është zhvilluar diskutim në Kuvend nga një pjesë e anëtarëve të Kuvendit sa ishin prezent, e që gjatë gjithë shqyrtimit të kësaj pike pothuajse në pjesën më të madhe prezent në sallë ishim 18 anëtar/e të Kuvendit.

Në shqyrtim e sipër pati një kërkesë që kjo pikë e rendit të ditës të shtyhet për një seancë të radhës në mënyrë që duke marrë për bazë faktin që propozimi është sjellë nga mbledhja e KPF-së si pikë shtesë, të ketë kohë më shumë për të analizuar këtë dokumentacion si dhe që anëtarët e Kuvendit të kenë më shumë informata rreth kësaj çështje.

Gjatë mbledhjes përkatësisht diskutimeve, pothuajse në fund të debatit për këtë pikë të rendit të ditës seanca mbetet pa kuorum për të vazhduar tutje ngase vetëm 17 anëtarë/e të Kuvendit ishin prezent në sallë, dhe si Kryesues i Kuvendit kam vlerësuar se kjo pikë e rendit të ditës për të cilën shqyrtimi ishte në përfundim e sipër, si dhe pika në vijim (Të ndryshme) nuk mund të shqyrtohen kështu që në bazë të Rregullores së punës së Kuvendit, e kam ndërprerë mbledhjen me konstatimin se e njëjta do të vazhdohet pas konsultimeve si dhe po sa të krijohen kushtet përkatëse, për çka do të bëhet njoftimi të gjithëve përmes e-mailit.

Si rrjedhojë e kësaj, konform rregullativës ligjore në fuqi, përmes kësaj Ftese ju njoftoj që seanca në fjalë do të vazhdoj më 28 maj 2025, nga ora 10:00 (para seancës së rregullt) në sallën e mbledhjeve të Kuvendit, dhe atë në pikën 10 të rendit të ditës, aty ku ka mbetur.

Sqarim:

Materiali i kësaj pike të rendit të ditës ju është përcjellë me Konstatimet e rekomanduara nga KPF më datë 16.04.2025

Me respekt

Podujevë,
Datë, 19 maj 2025

